VENDIM
Nr. 896, datë 24.12.2019

PËR DHËNIE SHTESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. VIKTOR KIÇO PAPAVANGJELI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror z. Viktor Kiço Papavangjeli, në masën e katërfishit të pensionit social, por shuma e pensionit, që përfiton sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë tetëfishin e pensionit social.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama